



Kryetar i Këshillit Drejtues  
Muharrem Nitaj

Nr. Prot.: 2/513  
Datë: 25/10/2013

Në bazë të nenit 13, pika 1.14, nenit 22, pika 1.3, nenit 65, pika 3, nenit 65, pika 5, nenit 79, pika 3, nenit 203, pika 1.1, dhe nenit 222, pika 1, të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2013, miratoi:

## RREGULLORE

### për themelimin dhe parimet e funksionimit të instituteve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"

#### Neni 1

##### Qëllimi dhe fushëveprimtaria e instituteve

Qëllimi dhe fushëveprimtaria e instituteve, të themeluara në bazë të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (në tekstin e mëtejme UP) dhe të kësaj Rregulloreje, mund të jenë mësimore, shkencore-hulumtuese, shërbime profesionale dhe artistike. Institutet, po ashtu, duhet t'i zhvillojnë strategjitë për shfrytëzimin e rezultateve të punës akademike, shkencore dhe artistike të Universitetit dhe për rritje të fondeve për mbështetje në realizimin e misionit të UP-së.

#### Neni 2

##### Organet e institutit

2.1. Organet e institutit janë:

- 2.1.1. Këshilli i institutit;
- 2.1.2. Drejtori i institutit;
- 2.1.3. Sekretari i institutit.

2.2. Nëse instituti e zgjeron punën e vet dhe angazhimet, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në bazë të kërkesës së arsyetuar të Institutit, mund të lejojë shtimin e numrit të stafit.

#### Neni 3

##### Këshilli i institutit

3.1. Këshilli i institutit përbëhet nga pesë anëtarë:

- 3.1.1. Prorektori për kërkime shkencore ose ndonjë përfaqësues tjetër i caktuar nga rektori i UP-së;
- 3.1.2. Prodekani për mësim i njësisë përkatëse akademike (nëse njësia akademike ka prodekan për shkencë, atëherë ai do të emërohet anëtar);
- 3.1.3. Shefi i departamentit përkatës (nëse instituti mbështetet në kapacitetet njerëzore të më shumë departamenteve, dekani i njësisë akademike e emëron një anëtar);
- 3.1.4. Një anëtar i stafit akademik i zgjedhur nga departamenti përkatës (nëse instituti mbështetet në kapacitetet njerëzore të më shumë departamenteve, këshilli i njësisë akademike e zgjedh një anëtar).

3.1.5. Një anëtar i jashtëm, nga komuniteti akademik, i biznesit apo i ndërmarrësisë, nga Kosova apo jashtë saj, i propozuar nga shefi i departamentit dhe i miratuar nga dekani i njësisë akademike (nëse instituti mbështetet në kapacitetet njerëzore të më shumë departamenteve, dekani i njësisë akademike ia propozon këshillit të njësisë akademike një anëtar për miratim);

3.1.6. Nëse instituti është themeluar dhe funksionon me përkrahjen e ndonjë institucioni, Këshilli do të kërkojë nga ai institucion që ta delegojë një anëtar.

3.2. Anëtarët e këshillit kanë mandat 4-vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

3.3. Këshilli e zgjedh kryesuesin nga radhët e veta.

3.4. Kryesuesi i thërret dhe i udhëheq mbledhjet e këshillit.

3.5. Vendimet në këshill merren me shumicë votash.

3.6. Drejtori i institutit është anëtar i këshillit të institutit, por pa të drejtë vote.

#### **Neni 4**

##### **Drejtori dhe sekretari**

4.1. Institutin e udhëheq drejtori i tij, i cili është përgjegjës për gjithë aktivitetin e tij hulumtues-shkencor dhe publikues.

4.2. Drejtori i institutit zgjidhet nga këshilli i institutit, me mandat 4-vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

4.3. Drejtori duhet të jetë nga radhët e stafit akademik (profesorëve) të departamentit përkatës apo njësisë përkatëse akademike (nëse instituti mbështetet në kapacitetet njerëzore të më shumë departamenteve).

4.4. Në punën e tij drejtori përkrahet nga sekretari i institutit, i cili propozohet nga drejtori dhe aprovet nga këshilli i institutit.

4.5. Sekretari duhet të jetë nga radhët e stafit akademik të departamentit apo njësisë përkatëse akademike.

4.6. Drejtori dhe sekretari duhet të përkujdesen për informimin, aranzhimin e takimeve, konferencave dhe të kryejnë punë të tjera të nevojshme, me përkushtimin që sa më shumë ta angazhojnë stafin e departamentit apo të njësisë përkatëse akademike.

#### **Neni 5**

##### **Financimi**

5.1. Aktivitetet e instituteve mund të financohen nga burimet vijuese:

5.1.2. Nga fondet publike, përfshirë UP-në;

5.1.3. Nga projektet;

5.1.4. Nga aktiviteti vetjak;

5.1.5. Nga donacionet;

5.1.6. Nga burime të tjera, në përputhje me ligjin dhe Statutin.

#### **Neni 6**

##### **Raportimi dhe llogaridhënia**

6.1. Në fillim të çdo viti akademik, drejtori i institutit e prezanton raportin vjetor për vitin e mbaruar akademik dhe planin vjetor për vitin vijues akademik për këshillin e institutit, në lidhje me aktivitetet e institutit.

6.2. Këshilli voton për ta aprovuar raportin vjetor dhe ndaras voton edhe për planin vjetor.

6.3. Kryesuesi i këshillit ia dorëzon raportin vjetor dhe planin vjetor të miratuar dekanit të njësisë akademike.

6.4. Dekani i njësisë akademike i procedon për miratim në Rektorat (te prorektori për shkencë) dhe në Këshillin Drejtues.

6.5. Këshilli Drejtues i shqyrton për miratim. Në kuadër të shqyrtimit, KD-ja e fton prorektorin për kërkime shkencore për konsultim.

## Neni 7

### Kontraktimi i punëve

7.1. Pas arritjes së marrëveshjes për kontraktimin e punëve, rektori, në bazë të të dhënave për marrëveshjen e arritur për kontraktimin e punëve, e nënshkruan kontratën, e cila duhet të përmbajë:

7.1.1. Të gjitha elementet e marrëveshjes së arritur;

7.1.2. Përcaktimin preciz të punëve dhe të detyrave të punës;

7.1.3. Vlerën precize të kontraktuar për secilin pozicion dhe punë;

7.1.4. Vlerën e tërësishme të punës;

7.1.5. Afatin e kryerjes së punës;

7.1.6. Mënyrën e pagesës dhe afatin e ekzekutimit të pagesës.

7.2. Para se të lidhet kontrata nga neni paraprak, drejtori i institutit, me pëlqimin e dekanit të njësisë akademike, e cakton bartësin e punës dhe kryerësit e tjerë të punëve, duke marrë si kriter themelor mendimin e kontraktuesit të punëve, kompetencat profesionale e shkencore të kryerësve të punës, si dhe mendimin e porositësit të punëve.

7.3. Në projektet dhe aktivitetet e veta, instituti mund të angazhojë edhe ekspertë jashtë UP-së.

## Neni 8

### Ndarja e mjeteve të realizuara dhe pagesa për punën e kryer

8.1. Pagesa e punëve të kryera bëhet sipas rregulloreve përkatëse të UP-së.

8.2. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara në bazë të punëve në specifikim do të bëhet në bazë të rregulloreve të Këshillit Drejtues të UP-së.

8.3. Shpenzimet direkte të krijuara gjatë punëve (shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet për blerjen e pajisjeve të nevojshme për realizimin e punëve, materiali harxhues, etj.) lejohen të jenë në lartësi maksimale 10% nga vlera e kontraktuar.

8.4. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara nga projektet apo shërbimet në bazë të punëve të kryera bëhet si vijon:

|   |             |
|---|-------------|
| Mjetet bruto të realizuara.....             | A           |
| TVSH-ja.....                                | B =0.13043A |
| Mbetja .....                                | C=A-B       |
| Shpenzimet direkte (10%) .....              | SHD = 0.1C  |
|   | D=C-SHD     |
| Për Universitetin.....                      | U = 0.2D    |
| Për fakultetin                              |             |
| a) Nëse shërbimet kryhen pa laborator ..... | F=0.1D      |
| b) Nëse shërbimet kryhen me laborator ..... | F=0.2D      |
| Personelit të angazhuar .....               | PA=D-(U+F)  |

8.5. Dekani i njësisë përkatëse akademike e përpilon raportin mbi ndarjen e mjeteve dhe ia dërgon shërbimit financiar, i cili e përpilon aktvendimin lidhur me pagesën e punëkryerësve dhe e jep urdhëresën për pagesën e mjeteve të destinuara sipas raportit të dekanit.

## **Neni 9**

### **Kërkesa për themelim të institutit**

- 9.1. Kërkesa për themelim të institutit adresohet fillimisht në këshillin e njësisë akademike.
- 9.2. Me rastin e kërkesës për themelim, departamenti apo njësia akademike e cila propozon duhet të draftojë rregulloren e punës së atij instituti, i cili duhet të jetë në përputhje me këtë rregullore.
- 9.3. Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës sjell vendim për miratim apo për mosmiratim të kërkesës.
- 9.4. Miratimi i Këshillit Drejtues për themelimin e institutit përfshin edhe miratimin e rregullores së punës, duke konfirmuar harmoninë me këtë rregullore.
- 9.5. Pas miratimit të kërkesës nga KD-ja dhe miratimit të rregullores së punës së atij instituti, njësia akademike mund të procedojë më tutje me zgjedhjen e organeve të institutit.
- 9.6. Institutet ekzistuese duhet t'i harmonizojnë rregulloret e punës me këtë rregullore dhe të njëjtat të dorëzohen për miratim në Këshillin Drejtues të UP-së, brenda afatit, 60 ditë pas miratimit të kësaj rregulloreje.
- 9.7. Dispozitat e kësaj Rregulloreje vlejnë edhe për galeritë, teatrot, si dhe për qendrat në kuadër të UP-së.

## **Neni 10**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga kryetari i Këshillit Drejtues të UP-së.

Kryetari i Këshillit Drejtues të UP-së

Muharrem Nitaj

The image shows the official seal of the University of Prishtina (UP) on the left, which is circular and contains the text "UNIVERSITETI PRISHTINES" and "UNIVERSITY OF PRISHTINA" along with the year "1970" and a sunburst emblem. To the right of the seal is a handwritten signature in blue ink, which appears to be "Muharrem Nitaj".